

**ANKESË NË  
ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT**

---

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **K.K. SKENDERAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **643-25-5186-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **034 - Ndërtimi i Objektit të Kompleksi i UÇK-së - objekti i Ç-së Skenderaj.**

**1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK / ANKUESIT:**

**LIMIT PROJECT SH.P.K. NUI: 811312561**

---

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**“Ahmet Gashi H1,L3, 1”**

*(Adresa)*

**Prishtinë, Kosovë**

*(Vendi)*

**10 000**

*(Kodi postar)*

**+38345401976**

*(Numri Telefonit)*

**N/A**

*(Numri i Faks-it)*

**LULZIM ZARAJ**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**limitproject.shpk@gmail.com**

*(Adresa elektronike)*

**02.07.2025**

*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË. Shëno të dhënat si në vijim:*

*(Emri i avokatit)*

---

*(Adresa e plotë)*

---

*(Numri i Telefonit)*

---

*(Numri i faks-it)*

---

*(Adresa elektronike)*

---

*(Data e parashtrimit të ankesës)*

---

*(Nënshkrimi dhe vula)*

---

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

**16.06.2025 - B05 Njoftim per Kontrat**

**16.06.2025 - Dosja e Tenderit**

**Afati i fundit për pranim të tenderëve / aplikacioneve:**

**data 28.07.2025 koha 14:00:00**

**Procedura e prokurimit      1 Procedurë e hapur**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Procesi i Hapjes së Ofertave / është hapur sipas rregulloreve dhe udhëzuesve për Prokurimi dhe është ngritur në platformë me kohë.

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

1. Me datë 17.06.2025 është paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim.
2. Me datë 23.06.2025 / Autoriteti Kontraktues ka refuzuar Kërkesën tonë për rishqyrtim

Të gjitha detajet janë të paraqituraa dhe Vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me Refuzimin e Kërkesës sonë.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

### II. BAZA LIGJORE E ANKESËS

Ankesa bazohet në dispozitat e mëposhtme të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP):

- Neni 7: Parimi i trajtesës së barabartë të operatorëve ekonomik.
- Neni 9: Parimi i mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.
- Neni 26.2: Kriteret për pjesëmarrje nuk duhet të jenë më të rënda sesa është e domosdoshme për realizimin e kontratës.
- Neni 65: Përcakton kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë, pa vendosur kufizime të tepërta ekonomike ose teknike që kufizojnë konkurrencën.
- Neni 108/A: E drejta e çdo pale të interesuar për të dorëzuar ankesë nëse beson se janë

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

### Pretendimi 1.

III. ARGUMENTIMI I ANKESËS Ne si subjekt ekonomik jemi të interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit, por konstatojmë se disa prej kërkesave në dosjen e tenderit përbëjnë pengesë të paarsyeshme dhe të pajustificuar për pjesëmarrje, si më poshtë: 2.3. Qarkullimi financiar joproporcional (Neni 26.2 i LPP) Kërkesa për qarkullim vjetor = 7,990,000 € për 3 vite, ndërkohë që vlera e kontratës është vetëm 3,995,500 €, është disproporcionale dhe nuk e përfaqëson realisht rrezikun financiar të projektit. Kjo shkel parimin e proporcionalitetit dhe bie ndesh me praktikën e drejtës së BE-së për prokurim publik (Direktiva 2014/24/EU, Neni 58), ku thuhet se kërkesat për kapacitet ekonomik nuk duhet të kalojnë dyfishin e vlerës së kontratës.

### Pretendimi 2.

- Kushtet e tepruara për staf dhe certifikime individuale (Nenet 7, 9 dhe 26) Kërkesat që çdo inxhinier të ketë certifikime specifike si ISO 9001, OHSAS 18001, IPMA, etj., janë kërkesa që zakonisht i përkasin nivelit të kompanisë dhe jo individëve. Kjo paraqet pengesë joproporcionale dhe diskriminuese, duke përjashtuar operatorët me staf të kualifikuar por pa certifikime formale për secilin individ, kështu që kërkesa e favorizojnë vetëm një kompani. 2. Kapitali financiar prej 1,200,000€ euro është i panevojshëm përderisë qëdo punë që kryhet do të paguhet nga autoriteti.

## **Përgjigja e Autoritetit Kontraktues:**

### **Përgjigje sa i përket qarkullimit financiar**

- Në bazë të Nenin 68 gjendja ekonomike dhe financiare qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës, AK ka vepruar në bazë të këtij neni sepse nëse bëhen llogarit vlera e qarkullimit nuk e kalon dyfishin e kontratës andaj kërkesa mbetet e pandryshuar.

### **Përgjigje për kapitalin financiar:**

- Për shkak të praktikave të fundit jo vetëm nga autoriteti ynë po në të gjitha institucionet e Kosovës për shkak të rasteve të dështimit të realizimit të projekteve të ndjeshme të objekteve të ngjashme ne si AK kemi vendosur këtë kërkesë si masë e sigurisë se kompanitë duhet të kenë kapacitet financiar dhe ekonomik të mjaftueshme për realizimin e këtij projekti.

## **Ankesë në Përgjigjen e Autoritetit Kontraktues:**

Duke iu referuar dokumentacionit të prokurimit për procedurën. Megjithatë, dëshirojmë të paraqesim se në lidhje me kriterin e kërkuar për qarkullimin vjetor, i cili në këtë rast paraqet një vlerë relativisht të lartë. Kjo vlerë mund të përjashtojë shumë operatorë ekonomikë të kualifikuar dhe me kapacitete të plota për përmbushjen e kontratës, por që nuk arrijnë vlerën e kërkuar të qarkullimit vjetor, veçanërisht nëse projekti për të cilin është hapur tenderi nuk ka një kompleksitet që justifikon një kërkesë kaq të lartë. Në këtë kontekst, kërkojmë që të shqyrtoni mundësinë e uljes së pragut të qarkullimit vjetor të kërkuar, në përputhje me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik, për të nxitur konkurrencën dhe për të siguruar pjesëmarrjen e një game më të gjerë operatorësh ekonomikë. Një qasje e tillë do të ishte në përfitim të Autoritetit Kontraktues, duke rritur gjasat për të marrë oferta më të favorshme, si në aspektin financiar, ashtu edhe atë teknik. Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe jemi në dispozicion për çdo sqarim shtesë që mund të kërkohej nga ana juaj.

### **Pretendimi 3.**

4.1. Menaxher I Projektit - Inxhinier apo Master të dip. në Ndërtimtari me së paku 7 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Të jetë I certifikuar si Auditor i cilësisë ISO 9001, Auditor për sistemet e menaxhimit të sigurisë OHSAS 18001, çertifikuar si specialist i mjedisit dhe çertifikuar për organizimin dhe menaxhimin e punishteve të ndërtimit.-Të gjitha keto qertifikime janë të panevojshme dhe kufizuese ku shumica e ndertueseve te lartë stafin e kanë pa keto qertifikime,kerkesa jonë është qe te hiqen nga dosja keto qertifikime pasi janë të panevojshme dhe kufizuese.

### **Pretendimi 4.**

4.2.Një Inxhiner ose Master I dip. I Arkitekturës së paku 2 përvojë pune profesionale (pas diplomimit). Te jete I çertifikuar për auditimin e energjisë në ndërtesa. I certifikuar për Ekspert i Sigurise dhe Shendetit në Punë nga MPMS MFPT.-Qertifikimet sidomos nga MPMS MFPT është qertifikim diskriminues dhe I panevojshëm pasi nje inxhinier nuk ka mundësi ta luaj rolin e nje personi te sigurisë,nuk mund ti merr pergjegjesit e sigurise

### **Pretendimi 5.**

4.3. Një Inxhinier apo Master i dip. i Hidroteknikës - së paku 3 përvojë pune profesionale ( pas diplomimit) certifikuar për Ekspert për SSHP-se nga MFPT, icili duhet te posedoj Certifikim për menaxhimin e Projekteve - IPMA minimum niveli D, i certifikuar si Auditor i cilësisë ISO 9001 dhe çertifikuar për organizimin dhe menaxhimin e punishteve të ndërtimit.-Certifikata e ekspertit për SSHP nga MFPT i certifikuar per projekte nga niveli D është kriter diskriminues,favorizues pasi edhe vet kompania e cila do ta fitoj këtë project deri me tani asnje project nuk e ka perfunduar me kete personel edhe pse do ti paraqet punët e kryera.Kerkojme te largohet ky kriter dhe te ju jepet mundësia edhe kompanive te tjera te marin pjese ne kete tender.Po ashtu vet niveli D nuk ka perputhje me kerkesen e Autoritetit edhe pse është diskriminues.

### **Pretendimi 6.**

4.4. Një Inxhinier apo Master i dip. i Hidroteknikës - së paku 7 përvojë pune profesionale ( pas diplomimit) certifikuar për instalimin e gypave dhe sigurinë e kanalit.-Perderisa ne kerkesen 4.3 dhe 4.4 keni kerkuar inxhinier te Hidroteknikes tregon qe kjo dosje eshte e sterngarkuar per te kufizuar pjesmarrjen e kompanive te tjera,poashtu kerkojme qe te largohet qertifikimi per instalimin e gypave dhe sigurine e kanalit pasi qe nuk munde te jet Certifikimi me I rendesishem se Shkolla te cilen e ka kryer inxhinieri.Certifikimet janë kufizuese ne kete procedur.

Pretendimi 7.

4.5. Një (1) Inxhinier apo Master i dip. i Gjeodezisë së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit). I Licencuar. Te jete I certifikuar per organizimin dhe menaxhimin e punishteve të ndërtimit. Kerkojmë qe te hiqet qertifikimi I Gjeodetit pasi është I panevojshëm dhe kufizues

Pretendimi 8.

4.6. Një Inxhinier apo Master i dip. ndërtimtaris, me përvojë së paku 5 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit). Te jete certifikimi dhe i trajnuar për penetrim ose testim visual. Tek inxhinieri I ndertimtarise kerkojme qe te hiqet certifikimi dhe trajnimi për penetrim ose testim visual,kerkojme te hiqet ky Certifikim pasi është diskriminues dhe favorizues.

Pretendimi 9.

4.7. Një (1) Inxhinier apo Master i dip. i Mjedisit së paku 5 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit). TTe jete i certifikuar si Ekspert i SSHP nga MFPT dhe Mbrojtje nga Zjarri nga AME si dhe I certifikuar për Vleresim te Rrisqeve nga AME.-Sa I perket inxhinierit te mjedisit te jet I Certifikur si expert I SSHP nga MFPT dhe me mbrojtje nga zjarri nga AME si dhe I certifikuar për Vleresim te Rrisqeve nga AME,kerkojmë qe te hiqen te gjitha keto Certifikime pasi jan kufizuese dhe diskriminuese,pasi ju garantoj qe me kete qertifikim kompania punet te cilet I ka kryer ku do ti dorzoj per te aplikuar ne kete project nuk do te ket asnje pune te kryer me kete staf,pasi ky qertifikim dhe kjo kerkese eshte kufizuese,kerkojme qe te hiqet kjo pike dhe te a lejohet pjesmarja ne kete project.

### **Përgjigja e Autoritetit Kontraktues:**

#### **Përgjigje për stafin profesional dhe teknik pika. 4.1 deri pika 4.7.**

- Përputhshmëria e kritereve të stafit me natyrën e projektit, niveli i stafit profesional i kërkuar është përcaktuar në përputhje me Nenin 69 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP Nr.03/L-241) dhe ka për qëllim që të sigurojë që Operatorët ekonomik potencial të mundshëm për realizimin e këtij projekti duhet të kenë kapacitetet e mjaftueshme teknike dhe profesionale për realizimin e projektit.

Kriteret janë formuluar në përputhje me Nenin 68 dhe 69 të LPP-së dhe nuk krijojnë pengesa të panevojshme për konkurrencë.

### **Ankesë në Përgjigjen e Autoritetit Kontraktues:**

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues është e mangët dhe nuk adreson në mënyrë substanciale pretendimet tona. Kërkesat për certifikime specifike për secilin nga profesionistët teknikë janë jo vetëm të panevojshme për natyrën e kontratës, por edhe qartazi kufizuese dhe diskriminuese, duke kufizuar padrejtësisht pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që përndryshe janë të kualifikuar. Më konkretisht:

- **Menaxheri i Projektit:** Kërkimi për një numër të madh certifikatash (ISO 9001, OHSAS 18001, specialist i mjedisit, menaxhim i punishteve) është i tepruar dhe jo i justifikuar nga kërkesat reale të projektit. Një menaxher i aftë nuk kushtëzohet nga numri i certifikatave, por nga përvoja e tij menaxheriale.
- **Inxhinieri i Arkitekturës:** Kërkesa për certifikim si auditor energjie dhe ekspert sigurie (nga MPMS) është jo-relevante për një profesionist që merret me projektim dhe mbikëqyrje arkitektonike, dhe në praktikë nuk është rol i përshtatshëm për t'u bartur nga një arkitekt.
- **Inxhinieri i Hidroteknikës (4.3):** Kërkesa për certifikim për SSHP nga MFPT dhe për menaxhim projekti IPMA (niveli D) është selektive, pa lidhje direkte me përmbushjen teknike të kontratës, dhe e përshtatur në mënyrë të tillë që i përgjigjet kapaciteteve të një operatori të caktuar.
- **Inxhinieri i Hidroteknikës (4.4):** Kërkesa për certifikim për instalimin e gypave dhe sigurinë e kanalit është e pakuptimtë kur personi është inxhinier i diplomuar me përvojë të konsiderueshme; diploma dhe përvoja janë prova më e mirë për kualifikim, jo certifikata shitesë të tepërta.
- **Inxhinieri i Gjeodezisë:** Kërkesa për certifikim për menaxhimin e punishteve të ndërtimit është joracionale për një gjeodet, sepse kjo nuk është në përputhje me fushën dhe përgjegjësitë profesionale të një inxhinieri gjeodet.
- **Inxhinieri i Ndërtimtarisë:** Kërkesa për certifikim për penetrim ose testim vizual është jo e domosdoshme për këtë pozitë dhe nuk është e lidhur drejtpërdrejt me detyrat inxhinierike në kuadër të këtij projekti.
- **Inxhinieri i Mjedisit:** Kërkesat për certifikime të shumta (SSHP nga MFPT, mbrojtje nga zjarri nga AME, dhe vlerësim rrezikshmërie) janë të tepruara dhe shkojnë përtej nevojave reale të projektit. Një inxhinier mjedisi nuk është detyrimisht përgjegjës për të gjitha këto fusha të specializuara.

Andaj, këto kritere, në tërësinë e tyre, nuk shërbejnë për të garantuar një realizim më cilësor të projektit, por synojnë të kufizojnë konkurrencën dhe të orientojnë procedurën drejt një operatori të paracaktuar. Kërkojmë me ngulm që të gjitha këto kritere të rishikohen dhe të përputhen me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

### **Për ekspertin profesional dhe teknik:**

Duke marrë parasysh që përgjigja e Autoritetit Kontraktues nuk e trajton në mënyrë të plotë, të arsyetuar dhe profesionale ankesën tonë lidhur me kriteret teknike të vendosura për stafin profesional, kërkojmë nga ana e ekspertit të OSHP-së që të bëjë një **shqyrtim profesional, të paanshëm dhe të detajuar për secilin inxhinier të kërkuar në dosjen e tenderit**, dhe të vlerësojë nëse këto kërkesa janë të justifikuara teknikisht dhe në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe parimet e konkurrencës së ndershme.

Në vijim paraqesim kërkesën tonë që për secilin pozicion të kërkuar të jepet vlerësim i veçantë:

1. **Menaxheri i Projektit:** Të vlerësohet nëse kërkesa për të qenë i certifikuar në *ISO 9001, OHSAS 18001, specialist i mjedisit dhe menaxhim punishtesh* është e nevojshme për këtë rol, apo përbën ngarkesë të panevojshme dhe kufizuese që shkon përtej kërkesave reale të projektit.
2. **Inxhinieri i Arkitekturës:** Të jepet një vlerësim nëse kërkesa për certifikim për auditim energjetik dhe ekspert për siguri dhe shëndet në punë nga MPMS është në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e një arkitekti dhe nëse është proporcional me llojin e kontratës.
3. **Inxhinieri i Hidroteknikës (pozita 4.3):** Të shqyrtohet nëse kërkesat për certifikim për SSHP nga MFPT, IPMA niveli D, auditor cilësie ISO 9001 dhe organizim punishtesh janë të gjitha njëkohësisht të nevojshme, apo përbëjnë kufizim të panevojshëm.
4. **Inxhinieri i Hidroteknikës (pozita 4.4):** Të vlerësohet nëse kërkesa për certifikim për instalimin e gypave dhe sigurinë e kanalit është teknikisht e justifikuar, duke marrë parasysh që kemi të bëjmë me një inxhinier të fushës përkatëse me përvojë të mjaftueshme.
5. **Inxhinieri i Gjeodezisë:** Të shqyrtohet nëse certifikimi për organizimin dhe menaxhimin e punishteve është relevant për një profesionist të gjeodezisë dhe nëse ndikon në përmbushjen cilësore të kontratës.
6. **Inxhinieri i Ndërtimtarisë:** Të vlerësohet nëse kërkesa për trajnime të specializuara për penetrim dhe testim vizual është domosdoshmëri teknike për projektin, apo një kusht që mund të përjashtojë padrejtësisht pjesëmarrës të kualifikuar.
7. **Inxhinieri i Mjedisit:** Të analizohet nëse kërkesat për certifikime të shumta (SSHP nga MFPT, mbrojtje nga zjarri dhe vlerësim risku nga AME) janë realisht të domosdoshme apo tejkalojnë kërkesat minimale për kompetencën profesionale të këtij pozicioni.

Pretendimi 10.

6. Raporti i vlerësimit të riskut për kompani. për të gjitha pozitat e kërkuara. - Ne kërkojmë që kjo kërkesë të largohet pasi kemi ankesa edhe për pikat me lartë dhe në momentin që të pranohet kërkesa jonë ky raport është i paarsyeshëm të qendroj, për mos me qenë diskriminues kjo procedure raporti për të gjitha pozitat e kërkuara të largohet.

### **Përgjigja e Autoritetit Kontraktues:**

#### **Përgjigje për raportin e vlerësimit të riskut**

- Ky kriter është formuluar në përputhje me Nenin 68 dhe 69 të LPP-së dhe nuk krijon pengesa për konkurrencë, përkundrazi është kërkesë që dëshmon se kompania dhe stafi kanë certifikimin e nevojshëm për realizimin e projektit sipas kushteve të sigurisë, shëndetit dhe riskut sipas standardeve dhe legjislacionit të kërkuar në vendin tonë.

### **Ankese mbi përgjigjen e Autoritetit Kontraktues:**

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues është e mangët dhe nuk trajton në mënyrë të plotë dhe të arsyetuar thelbin e ankesës sonë. Kërkesa që të dorëzohet *raport i vlerësimit të riskut për të gjitha pozitat e kërkuara* është e panevojshme dhe e paarsyeshme, dhe bie ndesh me parimet e proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme.

Në përputhje me praktikën e prokurimit publik, mjafton që operatori ekonomik të ketë një raport të përgjithshëm të vlerësimit të riskut në nivel kompanie, si pjesë e dokumentacionit standard të sigurisë dhe shëndetit në punë. Kërkesa që një raport risku të bëhet *individualisht për secilën pozitë të ofruar në kuadër të projektit* është tej specifike, nuk



ka bazë reale teknike për këtë fazë të tenderimit, dhe për pasojë, ka efekt kufizues dhe diskriminues ndaj pjesëmarrësve të tjerë në procedurë.

Për më tepër, duke qenë se kemi ngritur edhe ankesa të tjera për specifikimet e stafit profesional (pretendimet 3 deri 9), kërkesa për raport rrisht për secilën pozitë humbet objektin e saj dhe bëhet e pavlefshme në momentin kur kërkesat për personelin nuk janë më të qëndrueshme.

Në këtë kontekst, kërkojmë që ekspertët shqyrtues të vlerësojnë këtë kriter si joproporcional, i pajustificuar dhe i panevojshëm teknikisht, dhe që në përputhje me ligjin, të rekomandojnë largimin e tij nga dosja e tenderit në mënyrë që të garantohet konkurrencë reale dhe mosdiskriminim ndërmjet operatorëve ekonomikë.

#### Pretrendimi 11.

1 MiniEskavator max 1t-kerkojme te na tregoni se per cilin pozicion kerkohet ky eskavator? 1

2 MiniEskavator max 3.5t-per cilin pozicion nevojiten dy eskavatora me kete peshë? 2

3 Eskavator me lopat dhe pirun teleskopik 12-14t-kufizimi 12 deri ne 14Ton është kufizim diskriminues dhe kunder ligjeve te Prokurimit,po ashtu eskavatori me lopat dhe pirun teleskopik është krites vetem qe mos ti lejoj kompanit e tjera te marin pjes ne kete procedur dhe kerkojme qe te largohet ky kriter diskriminues. 1

4 Eskavator 20-23t-Diskriminues,te largohet 3

5 Eskavator 28-30t-Diskriminues,te largohet 1

6 Eskavator 35-40t- Diskriminues,te largohet 2

7 Miningarkues max 2t- Diskriminues,te largohet 1

8 Lugë ngarkuese me lopat dhe pirun 5-6t-Kufizimi 5-6 Ton diskriminues te largohet. 1

9 Lugë ngarkuese 12-13t-Kufizimi 12-13t diskriminues te largohet. 1

10 Luge ngarkuese 27-30t-Kufizimi 27-30t diskriminues te largohet. 1

11 Kamion min 17t-Kufizimi 17t diskriminues te largohet.

12 Kamion kiper me vinç me peshë bartëse 2-3t Kufizimi 2-3t diskriminues te largohet. 1

13 Kamion me kran me peshë bartëse 13-14t- Kufizimi 13-14t diskriminues te largohet. 1

14 Buldozher 7-8t-Kufizimi 7-8t diskriminues te largohet. 1

16 Buldozher me goma 30-34t- Kufizimi 30-34t diskriminues te largohet. 1

17 Greder 18-20t- Kufizimi 18-20t diskriminues te largohet. 1

18 Cilinder me dhembeza vibruet max 1.2t- Kufizimi 1.2t diskriminues te largohet. 1

19 Cilinder 1.5-2t- Kufizimi 1.5t diskriminues te largohet. 1

21 Cilinder me dhembeza min 18t- Kufizimi 18t diskriminues te largohet. 2

25 Pompë betoni me lartësi min 62m-Kufizim i panevojshëm pasi qe vet objekti nuk e ka kete lartësi dhe është kriter “favorizues” dhe diskriminues. 1

28 Lift për ndërtimtari me lartësi 35-40m me peshë bartëse 800-1000kg-Ky kriter është diskriminues dhe mungon vetëm emri i kujt është pasi këto paisje në vendin tonë mund ta posedojë vetëm 1 kompani, të largohet pasi është kriter i cili po na e pamundëson pjesëmarrjen në këto procedurë. 1

30 Vinq për transport të materialit ndërtimor me platformë-Te largohet pasi është kufizues dhe diskriminues 1

35 Tregëre prej druri-Te specifikohet me saktë ky pozicion 1500m<sup>2</sup>

38 Gjenerator min 200kw-Aty kryhet punë e ndërtimtaris dhe nuk është fabrik prodhuese që duhet patjetër ky gjenerator, të largohet pasi është diskriminues dhe jo i domosdoshëm për punime. 1

43 Sharrë për prerjen e drasave me disk-Te tregohet për cilin pozicion duhet kjo sharrë dhe pse duhet të jep patjetër me disk, nëse nuk ka ndonjë arsye të largohet.

### Ankesë mbi përgjigjen e Autoritetit Kontraktues:

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues është e përgjithshme, jo e arsyetuar dhe nuk adreson aspak shqetësimet legjitime tona si operator ekonomik. Kërkesat për 43 pajisje të ndryshme, shumica me specifikime shumë të ngushta të tonazhit dhe karakteristikave, janë të panevojshme teknikisht, joproporcionale me natyrën dhe vlerën e projektit, dhe mbi të gjitha të dizajnuara në mënyrë të tillë që favorizojnë një numër shumë të kufizuar operatorësh, gjë që bie ndesh me nenin 7, par. 4 dhe 6 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe me parimet e konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit.

Kërkojmë që ekspertët e OSHP-së të vlerësojnë secilën nga kërkesat si në vijim:

#### Pajisje të kërkuara me tonazhe/jo fleksibile – të gjitha vlerësohen si kriter diskriminues dhe kufizues:

Pajisja	Përgjigja jonë
1. MiniEskavator max 1t	Nuk sqarohet për cilin pozicion përdoret. Kjo kërkesë duhet të jetë fleksibile ose të sqarohet qëllimi, përndryshe është e panevojshme.
2. MiniEskavator max 3.5t	Pse nevojiten dy pajisje me këtë tonazh? Kjo nuk është e arsyetuar, kërkohet sqarim teknik dhe funksional.
3. Eskavator 12–14t me pirun	Tonazhi 12–14t është i kufizuar. Nëse kërkohet një minimum performance, duhet të specifikohet vetëm <i>tonazhi minimal</i> , jo një interval i ngushtë që përjashton pajisje ekuivalente.
4–6. Eskavatorë 20–23t, 28–30t, 35–40t	Kërkesat janë të paarsyeshme. Kufizimi i tonazhit nga–deri është <b>jodomosdoshmëri teknike</b> dhe kufizon operatorët që zotërojnë eskavatorë me kapacitet pak më të vogël apo më të madh.
7. Mini-ngarkues max 2t	Kriter teknikisht i paargumentuar. Duhet të specifikohet vetëm funksioni i nevojshëm, jo tonazhi fiks.
8–10. Lugë ngarkuese 5–6t, 12–13t, 27–30t	Kërkesat me tonazh fiks janë joproporcionale me nevojën reale. Një operator me një pajisje 4.5t ose 14t përjashtohet pa arsye logjike.
11. Kamion min 17t	Nëse nevojitet bartje materiale, të specifikohet vëllimi ose aftësia minimale, jo një tonazh i fiksuar arbitrarisht.
12–13. Kamionë me kran 2–3t, 13–14t	Kufizim i qartë teknik dhe tregues i orientimit të dosjes për operatorë të caktuar.
14. Buldozher 7–8t	Pse nuk është i pranueshëm një buldozher 6.5t ose 9t? Ky tonazh nuk është i standardizuar në tregun vendor.
16. Buldozher me goma 30–34t	Kufizim i panevojshëm teknikisht – përpunimi i terrenit mund të bëhet edhe me pajisje me tonazh tjetër të përafërt.



17. Greder 18–20t	Grederët variojnë shumë në tonazh. Kjo kërkesë është pa bazë dhe diskriminon operatorët që kanë pajisje të tjera të njëjta në funksion.
18–19. Cilindra vibrues 1.2t, 1.5–2t	Tonazhe që nuk ndikojnë në rezultat, përjashtojnë pajisje standarde të tjera për të njëjtin funksion.
21. Cilindër me dhëmbëza min 18t	Kërkesë e paarsyetuar në raport me nevojën e ngjeshjes – të jepet vetëm tonazhi minimal ose alternativë.
25. Pompë betoni min 62m	<b>Kriter favorizues dhe teknikisht i pajustificueshëm</b> – lartësia e objektit në projekt nuk kërkon këtë kapacitet.
28. Lift ndërtimi 35–40m / 800–1000kg	<b>Evident diskriminues</b> – këtë lloj pajisjeje e posedon vetëm 1 operator në treg. Të largohet ose të zëvendësohet me specifikim të përgjithshëm teknik.
30. Vinç me platformë	Kërkohet funksioni, jo tipi specifik. Kriter i panevojshëm dhe kufizues.
35. Tregere druri 1500m <sup>2</sup>	Pa përshkrim funksional, mungon justifikimi teknik. Pse pikërisht kjo sasi?
38. Gjenerator min 200kw	<b>Projekt ndërtimi nuk është fabrikë.</b> Ky kapacitet energjie është tejet i ekzagjeruar dhe pa mbështetje teknike.
43. Sharrë me disk	Të specifikohet pozicioni dhe funksioni përse kërkohet pikërisht sharrë me disk. Përndryshe është kriter arbitrar.

#### Argument shtesë:

- Kërkesa për 43 pajisje me specifika të detajuara, disa në numër të shumëfishtë, për një projekt me vlerë afërsisht 4 milionë euro, është tejet e ekzagjeruar dhe e paarsyetuar teknikisht. Kjo përbën një hiperbolizim të nevojave reale, çka tregon për përpilimin jo objektiv të dosjes së tenderit.
- Mjafton një listë prej 10–12 pajisjesh thelbësore me përshkrim të funksionalitetit dhe kapacitete minimale, pa specifikime të tilla të ngushta të tonazhit ose tipit të pajisjes (p.sh., “eskavator me kapacitet minimal X”, “kamion transporti me ngarkesë min. X m<sup>3</sup>” etj.) ose edhe Kapacitetin Maksimal.

#### Kërkesë për ekspertin shqyrtues:

Në përputhje me nenin 65 dhe 66 të LPP-së, kërkojmë që eksperti të:

- Vlerësojë çdo kërkesë të lartpërmendur si **diskriminuese dhe joproportionale**;
- Rekomandojë **reformulimin e specifikimeve të pajisjeve me minimum të nevojshëm teknik** dhe jo me kufizim të tonazheve ose markave të caktuara;
- Kërkojë që **lista e pajisjeve të zvogëlohet në përputhje me natyrën dhe madhësinë e projektit** dhe të përfshijë vetëm mjetet reale të domosdoshme për zbatimin e projektit.

#### Duke i parë shkeljet e paraqitura në detaje të:

- Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
- A01. Rregullore për Prokurimin Publik

#### I propozojme Panelit Shqyrtues dhe Ekspertit Profesional:

- Ankesën e paraqitur nga LIMIT PROJECT SH.P.K. NUI: 811312561 / t’a vlerësoi **si të BAZUAR**.
- Të **ANULOI** – Njoftimin për kontratë (BO5) / të realizon ndryshimet sipas propozimeve nga Eksperti (ose në rastin që ndryshimet janë të medha) të anulohet procedura / e të rihapet Ritenderimi.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Nuk paraqesim dëme në këtë fazë.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) Të gjitha dokumentacionet e nevojshme janë të paraqitura në Platformen Elektronike.*

**Si Operator Ekonomik po paraqesim dokumentacionin:**

- 1. Kërkesa për rishqyrtim**
- 2. Vendimi i Autoritetit Kontraktues**
- 3. Njoftimi për kontratë – Formulari B05.**